

BASHKIA DEVOLL
NJOFTIM PER DHENIE ME QIRA

7. Autoriteti: BASHKIA DEVOLL
Adresa : Bashkia Devoll, Lagja nr.1, Rr. 24 Tetori nr.9,
8. Dhenie me qira te siperfaqeve nga fondi kullisor me konkurim publik ne pronesi te Bashkise Devoll, Zona Kadastrale 2081, Numri i Pasurise 1920 ne ngastren 25 e cila ben pjese ne Ekonomine Kullosore “Bilisht” ne pronesi te Bashkise Devoll.
9. Qellimi i dhenies me qira te fondit kullisor me konkurim publik ne pronesi te Bashkise Devoll, Zona Kadastrale 2081, Numri i Pasurise 1920 ne ngastren 25 e cila ben pjese ne Ekonomine Kullosore “Bilisht” ne pronesi te Bashkise Devoll e llojit “Kullote” me siperfaqe 21.0152 ha është dhenia ne perdorim per zhvillimin ekonomik me destinacion per ndertim teleferik pasagjeresh ose linje te tensionit, Aerogjeneratore dhe Fotovoltaike etj.
10. Konkurrimi do te zhvillohet me date 12.10.2023 ora 11:00 ne Sallen e Keshillit Bashkiak, Bashkia Devoll
11. Çmimi dysheme i qirasë, është: Kullotë: 176,000 (Njëqindeshtatëdhjetëegjashtëmijë) lekë/ha në vit e përlogaritur sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.
12. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë tej afatit 10 (dhjetë) vjet.
13. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:
 - a) Garanci financiare e mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan biznes.
 - b) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës ,ku në CV – në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
 - c) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim,hetim në proces,detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve,
 - d) Vërtetim për shlyerjen e taksave,tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2023

14. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, dhe dokumentacionin si vijon :
- a) Kërkesë së bashku me të dhënat për sipërfaqen e kërkuar dhe gjeneralitetet e tyre;
 - b) Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë,
 - c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar,(i cili përmban hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi, objektet aktuale, si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar,hartuar konform kërkesave të projektit);
 - d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
 - e) Të dhënat për kapacitetet teknike,stafin makineritë dhe paisjet që zotëron;
 - f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
 - g) Nivelin e punësimit në veprimtari;
 - h) Raportin e vlersimit të ndikimit mjedis nga ekspertë të çertifikuar;
 - i) Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
 - j) Afati i qirasë.
 - k) Adresës e subjektit,telefonin,e-mail dhe faks.

Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

15. Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Devoll, para orarit të hapjes së ofertave.

16. Sigurimi i ofertës

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës,
Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së ofertës
Llogaritja bëhet: Vlera e qirasë X ha X vitet e qirasë X 2%

17. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:

- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet,(i cili përmban hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10.000,ku të jenë evidentuar elementët kryesorë,si kufijtë natyrorë,relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar,hartuar konform kërkesave të projektit)..... 20 pikë.
- b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen 15 pikë.
- c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes.....25 pikë.
- d) Nivelin e punësimit në veprimtari.....5 pikë.

e) Masën e qerasë për ha/vit35
pikë.

18. Informacion mbi dokumentet e konkurimit publik: Dokumentet e ankandit mund te trerhiqen prane autoritetit te dhenies me qera Bashkia Devoll.

Dokumente me pagesë: Po X

Nëse Po Monedha _____ Çmimi 1000 Leke

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.